

## PJESA II

*Tragjedia "Hamleti" është vepra më popullore e Shekspirit, e cila shtjellon luftën për fitoren e dinjitetit përballë veseve të kohës. Fragmenti më poshtë është shkëputur nga Akti III, Skena II. Këtu shfaqen ndjenjat e Ofelisë para çmendurisë së Hamletit dhe vetë ky, tepër i trishtuar nga tradhtia e të afërmve. Dialogu hedh dritë mbi kompleksitetin e jetës, të cilin do ta zbuloni pas një leximi të kujdesshëm.*

## SHEKSPIR

### HAMLETI

#### OFELIA

O perëndi e kij nën kujdes!

#### HAMLETI

N'u martofsh, të jap këtë mallkim si pajë: Qofsh  
E pastër si akulli, e bardhë si dëbora, prapë nuk  
Shpëton dot nga çpifja. Ecë në një manastir, shko  
udhën e mbarë. Ose në daç të martohesh doemos,  
martohu me ndonjë budalla, se burrat e mençur  
e dinë fort mirë çfarë shtaza me brirë po i bëni.  
Shko në manastir, dhe sa më shpejt. Lamtumirë!

#### OFELIA

O ëngjëjt e qiellit, sileni prapë ndër mënt.

#### HAMLETI

I di mjaft mirë fytyrëlyerjet tuaja. Perëndia ju  
Ka dhënë një fytyrë, dhe ju krijoni një tjetër për  
Vete. Losni, ngisni, belbëzoni e talleni me krijaturat  
E perëndisë dhe e paraqitni harvalërinë tuaj si me  
Padije. Dhe, ja ku të thom që s'ka martesë më; ata  
Që janë martuar gjer më sot, përveç njëjt,  
Kanë për të rrojtur; të tjerët do të mbeten ashtu si  
Janë. Shko në manastir.

(Del)

#### OFELIA

Oh, çfarë mëndje e lartë u përmbys këtu!  
Oh, çfarë sy e çfarë gjuh'e shpatë  
Ushtari, hoborrtari dhe shkollari,  
Q'ish trëndafil e shpres' e shtetit bukur  
Pasqyr' e modës, shëmbëll' e kulturës,  
M'i pam' i pamësve, krejt, krejt përdhe!  
Dhe unë, gruaja m'e mjerë e botës,  
Që ia thitha mjaltin e muzikën  
Nga dashuri e zëmrës, po ia shoh  
Bujaren, sovranen sqojtësi  
Si zile t'ëmbël të rrëzuar poshtë  
Që krisi, u çtingëllua dhe u ngjir,  
Këtë fytyr' e lul' e trim pa shoq,  
Q'u çthurr nga marrëzia! Mjera unë, oh!

Që pash' ato që pash' e shoh ato që shoh!  
(*Hyjnë përsëri Mbreti dhe Polloni*)

**MBRETI**

Jo zemr'e tij s'anon nga dashuria;  
Ato që foli, ndonëse pa lidhje,  
Nuk ishin marrëzi. Diç ka në shpirt  
Q'e nxeh dhe ia kllonit melankolinë;  
Dhe zogjtë që na nxjerr pa fjalë janë  
Fort të rrezikshëm; që t'i presim hovin,  
Vendosëm ta dërgojmë shpejt n'Angli  
Harçn' e prapambetur të kërkojë;  
Në dashtë zoti, deti, ndrrim i klimës,  
Shëtitjet e zbavitjet ia largojnë  
Idenë që iu ngul në zëmër brënda,  
Të cilën sa më tepër e mendon  
Aq'e shkallon. Si thua zotërore?

**POLLONI**

Bëj, imzot, si the;  
Dhe po të duash, mbas mbarimit lodrës,  
Mënjatë le ta ftoj'e ëma vetëm  
T'i shfaqë helmin; le t'i flasë shkoqur;  
Në daç, kam për t'u fshehur të dëgjoj  
Bashkëfjalimin. Në mos daltë gjë,  
E ç'o n'Angli, a e burgos gjëkund,  
Kudo që ta gjykosh më t'arsyeshme.

**MBRETI**

Sikundër thamë, pra, do proceduar,  
Se çmendja e të madhit do vëzhguar.  
(*Dalin*)